

Procesverbal

(ekstrakt)

Nga mbledhja e (V) - të e Pestë e Komitetit për Politik e Financa – Dragash , e mbajtur më 26/04/2022 me këtë :

Rend Dite

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e III- të (tretë)
- Shqyrtimi i materialit të kuvendit për seancën e VII- Shtatë
- Eventuale...

Z. Uran Halimi – Përshëndetje për të gjithë, e kemi mbledhjen e V (pestë)-të rregullt për vitin 2022 të Komitetit për Politikë e Financa

-E qesim ne votim rendin e ditës ...

Atëherë me 5 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim kalon ky rend i ditës.

E qesim ne votim miratimin e procesverbalit nga seanca e III-të ?...

Me 5 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim kalon procesverbalit....

Kalojmë te rendi i ditës që është paraparë për seancën e VII-të

Nëse dëshiron dikush ta marr fjalën ?....

Tash kalojmë te rendi i ditës që është paraparë për seancën e rregullt, është fjala për shpalljen e interesit publik të shitores Sharr-prodhimit në fshatin Bresanë, Nëse do dikush me marr fjalën ne lidhje me këtë ?.....

z.Artan Loshaj – Përshëndetje për të gjithë , kjo pikë e rendit ditës për mua është pak e pa qartë, është mirë me qenë Kryetari këtu, se edhe herën e kaluar nuk ishte, po meqenëse është Nënkyetari, mundet edhe aj me na shpjegua për çka bëhet fjalë , kur e dimë se gjatë mandatit të Partisë Demokratike kryetari i Komunës bashkë me kryesuesin e asamblesë , kanë qenë nëpër gjykata për tokën e Sharr-prodhimit.

Un e di që tokat e Sharr prodhimit nuk janë në menaxhim të Komunës po janë në menaxhim të Sharr prodhimit dhe kjo çështje është e pa definuar, përndryshe s'pe kuptoj e kom te paqartë.

z.Resul Fetahu- përshëndetje Kryesues, përshëndetje për të gjithë ..atëherë, kryetari i cili është më shumë i njoftuar me këtë rast, unë e di se do te bëhet park pra, objekti i policisë dhe ajo tjetra mbrapa saj.

z.Artan Loshaj- Nënkyetar e kom të qartë, jo po , më herët bujqit tanë, jo për diçka që unë qe po dua.... Bujqit tanë kur kërkojnë tokat e Kuvendit Komunal dokumentacionin e nxjerr në Komunë a qiranë e merr Sharr prodhimi, kryetari i Komunës edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal kanë qenë nëpër gjykata dhe çështja është ende e pazgjidhur, kjo është problemi, s'di a keni marr informacione

se qka ka ndodh dhe çka mund me ndodh në qoftëse na e shpallim me interes publik edhe në qoftë se ne e votojmë, kjo është problemi se unë e kam lexuar që po do mu bo park e kam të kjiartë, problemi është, qe Arjeta ku është e di shumë mirë që janë kon to shkua në burg. Amo ju është fal atyre prej personit në fjalë që është opojali e është i vendit ton se përndryshe shkojshin në burg për qeto çështje, s'di a keni marr informacione apo sa keni ardh po doni me punue, ishalla punoni mirë po këtu keni me has me ni gozhdë bajagi asi 16-tshe.

z.Uran Halimi – faleminderit Artan, a donë dikush tjetër me marr fjalën.

z.Qamil Kolloni- Edhe pse nuk jam i thirrur po meqenëse jemi këtu për sa i përket pronave unë desha të ja jap një sqarim Artanit se është e vërtet se në mungesë të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave realisht Komuna ka pas probleme sa i përket pronës së Sharr Prodhimit , mirëpo tash me ligjin për dhënien në shfrytëzim , dhe këmbim të pronave , parashihet në qoftë se Komuna e sheh si zonë të interesit të përgjithshëm, ose interesit publik ka mundësi të këmbimit të pronës mirëpo ne duhet të kryejmë hapat e par procedural, pra ne radhe te parë ta shpall si zonë me interes të përgjithshëm, dhe pas kësaj fillojnë hapat tjerë për këmbimin e pronës.

z.Artan Loshaj – A ka mundësi ta dijë cili ligj qenka qe pe përcaktoj ka.

z.Qamil Kolloni – A ka mundësi ta sjelli se nuk e dijë përmendesh ta sjelli ligjin dhe ta tregoj.

z. Munir Jonuzi - Të nderuar, Artani pyet mbi bazën e cilit Ligji, më duket se është neni 27, paragrafi 1. “Komunat kanë të drejtë të kërkojnë në interes publik kalimin e pronësisë së pronës së paluajtshme që ndodhet në komune e administruar dhe menaxhuar nga institucionet qendrore”. Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Së pari, Kuvendi duhet të marrë një vendim për shpalljen e interesit publik, dhe më pas si i tillë i dërgohet Qeverisë së Republikës së Kosovës ose departamentit përkatës, pas së cilës ata japin miratimin.

z.Uran Halimi - Nëse do me marr dikush tjetër fjalën , nëse jo e qesin në votim : kush është pro pikës së dytë ?

Atëherë me 4 Vota pro , 0 kundër dhe 1 Abstenim kalon edhe kjo pik e dytë e rendit të ditës e cila kishte të bëjë për vendimin e shpalljes zonë në interes publik e tokës së Sharr - prodhimit në fshatin Brodosanë

Tek pika e tretë e kemi propozim vendimin për demelimin e ndërtesës në f.sh Brodosanë , pronë e komunës se Dragashit, e cila i përket drejtoratit të punës së brendshme. Nëse do dikush me marr fjalën në lidhje me këtë pik, është fjala për demelimin e ish ndërtesës ku ka qëndruar ish policia jugosllave , ushtria a po policia serbe....

A do dikush me marr fjalën në lidhje me këtë pikë , pra këtij vendimi në lidhje me demelimin e kësaj ndërtese , nëse jo e hedhim ne votim?....

Me 4 vota pro, me 0 kundër dhe 1 abstenim kalon kjo pike e rendit te ditës.

Pika IV Raporti 3 mujor Financiar, nëse donë Drejtori me marr fjalën?.....

Atëherë e qesim ne votim me 4 Vota pro 0 kundër dhe 1 abstenim , kalon kjo pik e rendit të ditës

Pika tjetër ka të bëjë me propozim vendimin për transferimin e rezervës komunale

z. Uran Halimi- Atëherë te kjo a donë dikush me marr fjalën dhe nëse jo e ftojme drejtorin për të na dhënë një sqarim për çfarë është fjala....

z.Qamil Kolloni- realisht janë këto rezerva paraprake, të cilat kanë qenë vitin e kaluar, dhe janë kon të ndamë, dhe e kemi parë të arsyeshme që këtë vit t'i investojmë për vet faktin se ka edhe rritje të çmimeve si dhe kemi pas një kërkesë pak më emergjente.

Kështu që do ta diskutojmë për ta bërë edhe si çështje dhe duhet të diskutojmë për ta prurë si vendim, dhe mendoj se duhet të kalojë në Kuvend për diskutim.

z.Uran Halimi – a dëshiron dikush ta marr fjalën ?.... Në rregull mund ta hedhim ne votim

Atëherë me 4 vota pro 0 kundër dhe 1 abstenim kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Te pika e VI-të e kemi planin e punës së DKA-së.... a dëshiron dikush ta marr fjalën pasi që drejtori nuk është këtu ?..... atëherë e qesim në votim

Kush është pro?....

Me 5 vota pro , 0 kundër dhe 0 abstenim kalon edhe kjo pikë.

E kemi edhe pikën eventuale a dëshiron dikush ta marr fjalën?.....

Nëse jo e shpalli të mbyllur këtë takim.

Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa

Uran Halimi
